

DOKUMENTI KONSULTATIV

Projektligj “Për trajtimin financiar të artistëve performues pas ndërprerjes së veprimtarisë artistike skenike”

Ky ligj përcakton kushtet, kriteret dhe procedurat për përfitimin e trajtimit financiar nga punonjësit që kanë ushtruar profesione artistike performuese në institucionet publike të artit dhe kulturës, pas përfundimit të veprimtarisë së tyre profesionale skenike dhe deri në lindjen e të drejtës për pension pleqërie, invaliditeti ose familjar, sipas legjislacionit në fuqi për sigurimet shoqërore.

Kohëzgjatja e konsultimeve:

Konsultimet në portalin e Regjistrimit Elektronik: 20 ditë pune, duke filluar nga data 02 Shtator 2026 deri në datë 30 Shtator 2026.

Si të përgjigjeni:

Kontributet që në kuadër të procesit të konsultimit dhe përmirësimit të përmbajtjes së projektligjit, do të përcillen nga institucionet e interesuara me anë të regjistrimit elektronik në adresën <http://www.konsultimipublik.gov.al>.

Kontakti:

Eliverta Vraniçi

Eliverta.Vranici@mtks.gov.al

Datat dhe vendet e takimeve publike:

E-Konsultimi: në portalin “Regjistri Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike” 20 ditë pune, duke filluar nga data 02 Shtator 2026. Në muajin shtator do të zhvillohet një **takim konsultativ nga grupet e interesit** për projektligjin “Për trajtimin financiar të artistëve performues pas ndërprerjes së veprimtarisë artistike skenike”, me qëllim prezantimin e projektligjit dhe marrjen e mendimeve e sugjerimeve nga palët e interesuara.

Sfondi i propozimit legjislativ

Artistët performues ushtrojnë profesione me karakteristika të veçanta fizike dhe vokale, të cilat, për shkak të natyrës së tyre, nuk mund të vijohen në mënyrë të qëndrueshme deri në moshën e pensionit. Përfundimi i aktivitetit skenik në një moshë më të hershme krijon një periudhë pa mbështetje të mjaftueshme financiare deri në lindjen e të drejtës për pension. Për këtë arsye, propozohet krijimi i një skeme të posaçme të trajtimit financiar për artistët performues të institucioneve publike të artit dhe kulturës, që plotësojnë kriteret e përcaktuara për moshën, vjetërsinë në profesion dhe periudhën e sigurimit shoqëror.

Skema synon të sigurojë mbështetje financiare gjatë kësaj periudhe, të garantojë vazhdimësinë e sigurimit shoqëror dhe të vlerësojë kontributin e artistëve në jetën kulturore të vendit.

Propozimet

Projektligji propozon krijimin e një skeme të posaçme të trajtimit financiar për artistët performues të institucioneve publike të artit dhe kulturës, pas përfundimit të veprimtarisë së tyre skenike dhe deri në lindjen e të drejtës për pension.

Në mënyrë të veçantë, projektligji propozon:

Përcaktimin e profesioneve artistike performuese që përfshihen në skemë;

Përcaktimin e kriterëve të moshës, periudhës së performancës skenike dhe periudhës së sigurimit shoqëror;

Përfitim të trajtimit financiar në masën 70% të pagës bruto për 5 vitet e para dhe më pas 50% të pagës neto të profesionit përkatës;

Njohjen e periudhës së përfitimit si periudhë sigurimi shoqëror;

Financimin e trajtimit financiar dhe të kontributeve shoqërore nga Buxheti i Shtetit;

Përcaktimin e procedurave të verifikimit, administrimit dhe ndërprerjes së përfitimit;

Mundësinë e angazhimit të përfituesve në veprimtari trajnuese, kulturore, promovuese dhe mentorim profesional, pa ushtruar rregullisht profesionin skenik.

Pyetjet

Reagimet që priten janë të hapura dhe nuk parashikohet ngritja e pyetjeve specifike, të cilat kërkojnë përgjigje. Pyetje të mundshme mund të jenë: A pajtoheni me qartësinë e informacionit të paraqitur në dokument dhe çfarë do të propozoni shtesë për të përmirësuar cilësinë e tij? Si i vlerësoni përcaktimet në këtë projektligj.